

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 dhe 3 të Ligjit për gjykatat ("Gazeta Zyrtare e RM" nr.58/06...198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV" nr.96/19), nenit 63 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, të mbajtur më 23.02.2023, miratoi këtë:

Q Ë N D R I M P A R I M O R

Në procedurën e ankesës së deklaruar nga një gjyqtar përkatësisht kryetar i gjykatës kundër vendimit të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratuar në procedurën e përsëritur pas anulimit të Aktvendimit në përputhje me nenin 72 nga Ligji për Këshillin gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli për vendimmarrjen e ankesave pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund që drejtpërdrejtë të zbatojë Amendamentin XXI (neni 15) dhe neni 50 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nenin 6 dhe nenin 13 nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

A r s y e t i m

I. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 8

Vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë:

- liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë;
- të shprehurit e lirë të përkatësisë kombëtare;
- sundimi i së drejtës;
- ndarja e pushtetit shtetëror në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor;
- pluralizmi politik dhe zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike;
- mbrojtja juridike e pronësisë;
- liria e tregut dhe e sipërmarrësisë;
- humanizmi, drejtësia sociale dhe solidariteti;
- vet administrimi lokal;
- rregullimi dhe humanizmi i hapësirës dhe mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor dhe i natyrës dhe
- respektimi i normave përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut është e lirë çdo gjë, që nuk është e ndaluar me Kushtetutë dhe me ligj.

AMENDAMENTI VI

1. Përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve, të cilët u takojnë të gjitha bashkësive, në organet e pushtetit shtetërorë dhe institucionet e tjera publike në të gjitha nivelet.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti, plotësohet nënpika 2 e nenit 8 të Kushtetutës së Republikës të Maqedonisë së Veriut.

AMENDAMENTI XXI

1. Garantohet e drejta e ankesës kundër vendimeve të miratuara në procedurën e shkallës së parë para gjykatës.

E drejta e ankesës ose ndonjë lloj tjetër të mbrojtjes juridike kundër akteve të veçanta juridike, të miratuara në procedurën e shkallës së parë para organit administrativ apo organizatës ose ndonjë organi tjetër që kryejnë autorizime publike rregullohet me ligj.

2. Me këtë amendament zëvendësohet neni 15 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore

Neni 50

Çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të përcaktuara me Kushtetutë, para gjykatave dhe para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në procedurë të mbështetur mbi parimet e prioritetit dhe urgjencës.

Garantohet mbrojtja gjyqësore e ligjshmërisë së akteve të veçanta të administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera që ushtrojnë autorizime publike.

Qytetari ka të drejtë të njoftohet me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në mënyrë aktive të kontribuojë, individualisht ose bashkë me të tjerët, për përparimin dhe mbrojtjen e tyre.

AMENDAMENTI XXV

1. Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat. Gjykatat janë të mëvetësishme dhe të pavarura. Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës e të ligjeve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Ndalohen gjykatat e jashtëzakonshme. Llojet, kompetencat, themelimi, suprimimi, organizimi dhe përbërja e gjykatave, si dhe procedura para tyre, rregullohen me ligj, i cili nxirret me shumicë prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve.

2. Me pikën 1 të këtij amendamenti zëvendësohet neni 98 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë.

Neni 118

Marrëveshjet ndërkombëtare të cilat janë ratifikuar në përputhje me Kushtetutën janë pjesë e rendit juridik të brendshëm dhe nuk mund të ndryshohen me ligj.

II. KONVENTA EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Neni 6 (1)

E drejta për një proces të rregullt

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohej drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

III. LIGJI PËR GJYKATAT

Neni 2

(1) Gjykatat gjykojnë dhe vendimet e tyre i mbështesin në bazë të Kushtetutës, të ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën.

(2) Gjyqtarët në zbatimin e së drejtës i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

Neni 3

Qëllimet dhe funksionet e pushtetit gjyqësor përfshijnë:

- zbatimin e paanshëm të së drejtës, pavarësisht nga pozicioni dhe cilësia e palëve,
- mbrojtjen, respektimin dhe përparimin e të drejtave njerëzore dhe lirive themelore,
- sigurimin e njëjtësisë, barazisë, mos diskriminimit në çfarëdo lloj baze dhe
- garantimin e sigurisë juridike në bazë të sundimit të së drejtës.

Neni 5

(1) Gjykatat i mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të qytetarit dhe të drejtat e subjekteve tjera juridike nëse ajo sipas Kushtetutës nuk është në kompetencë të Gjykatës kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Qytetarëve dhe subjekteve tjera juridike u garantohet mbrojtje gjyqësore në raport me ligjshmërinë e akteve të veçanta të organeve të administratës shtetërore ose organizatave dhe organeve të tjera që kryejnë autorizime publike.

Neni 6 (1)

(1) Secili ka të drejtë në qasje të barabartë para gjyqit në mbrojtjen e të drejtave të tij dhe interesave të mbështetura juridikisht.

Neni 18

(1) Gjykata, paraqet iniciativë për ngritjen e procedurës për vlerësimin e harmonizimit të ligjit me Kushtetutën kur në procedurë do të parashtrahet çështja për përputhshmërinë e tij me Kushtetutën, për çka i informon drejtpërdrejt gjyqin më të lartë dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Kur gjykata konsideron se ligji që duhet të zbatohet në rastin konkret nuk është në harmoni me Kushtetutën, ndërsa dispozitat kushtetuese nuk mund direkt të zbatohen, do ta ndërpresë procedurën deri në marrjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Kundër vendimit me të cilin ndërpritet procedura në rastet nga paragrafi (2) të këtij neni, pala ka të drejtë ankese. Procedura ndaj ankesës është urgjente.

(4) Kur gjykata konsideron se zbatimi i ligjit në rastin konkret është në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar në pajtim me Kushtetutën, do t'i zbatojë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare, në kushte që ato të mund të zbatohen drejtpërdrejt.

(5) Gjykata, në rastet konkrete, në mënyrë të drejtpërdrejtë i zbaton vendimet definitive dhe përmbaruese të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të Gjykatës ndëshkuese ndërkombëtare ose të gjykatës tjetër, të cilën kompetencë e pranon Republika e Maqedonisë së Veriut, nëse vendimi është i përshtatshëm për përmbarim.

IV. LIGJI PËR KËSHILLIN GJYQËSOR

E drejta për ankesë

Neni 72

(1) Të drejtë ankese te Këshilli për vendimmarrje për ankesë pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut kundër vendimit të Këshillit, ka vetëm gjykatësi përkatësisht kryetari i gjykatës për të cilin është ngritur procedura për përcaktimin e përgjegjësisë, në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

(2) Këshilli për Ankesë është i përbërë prej nëntë anëtarëve, prej të cilëve tre gjykatës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga një gjykatës nga gjykatat e apelit dhe dy gjykatës nga gjykata nga e cila është gjykatësi kundër të cilit është mbajtur procedura. Anëtarët zgjidhen publikisht me short në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht seancën e të gjithë gjykatësve të gjykatës përkatëse, më së voni në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(3) Këshilli për Ankesë më së voni në afat prej 30 ditësh nga formimi i tij vendos për ankesën, duke e vlerësuar ligjshmërinë e procedurës.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, Këshilli për Ankesë mund ta konstatojë apo ta anulojë aktvendimin e Këshillit në rast të shkeljes së rëndë të dispozitave të përgjegjësisë të gjykatësit ose kryetarit të gjykatës.

(5) Nëse Këshilli për Ankesë e anulon aktvendimin, Këshilli do ta përsërisë procedurën, detyrimisht duke i respektuar udhëzimet e Këshillit për Ankesë dhe do të marrë vendim dhe të njëjtin publikisht do ta shpallë në ueb-faqen e vet.

(6) Kundër vendimit nga paragrafi (5) i këtij neni nuk lejohet ankesë ose padi.

(7) Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatësi, respektivisht kryetari i gjykatës, pjesëmarrës në procedurën para Këshillit nuk mund të jenë anëtar të Këshillit për Ankesë nga paragrafi (2) i këtij neni.

E drejta për gjykim të drejtë

Neni 74

Gjatë procedurës para Këshillit, gjykatësi ose kryetari i gjykatës kundër të cilit mbahet procedura ka të drejtë në gjykim të drejtë në pajtim me garancitë e përcaktuara në nenin 6 të Konventës evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

V. DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE, MENDIME DHE PRAKTIKA GJYQËSORE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Në Deklaratën universale për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara konstatohet se secili ka plotësisht të drejtë të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të pavarur dhe të paanshme.

Në Parimet themelore për pavarësinë e gjyqësorit të miratuara nga Mbledhja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, shënohet se gjyqtari ka të drejtë për gjykim të drejtë. Të gjitha procedurat disiplinore, procedurat e pezullimit ose të shkarkimit doemos të jenë të rregulluara në përputhje me standardet e vendosura të procedurës gjyqësore.

Këshilli konsultativ i gjyqtarëve evropian (*KSES/SSJE*) në Mendimin nr. 3, pika 72, lidhur me përgjegjësinë disiplinore, thekson se rregullimi i procedurave disiplinore në çdo shtet duhet të mundësojë ankesë nga trupi fillestar disiplinor (pavarësisht nëse bëhet fjalë për një organ, tribunal ose një gjykatë) në gjykatë.

Çdo procedurë e filluar disiplinore duhet të jetë e caktuar nga një organ i pavarur ose tribunal që do të zhvillojë procedurën e cila garanton të drejtën e plotë të mbrojtjes.

Deklarata e madhe e gjyqtarëve të Këshillit konsultativ të gjyqtarëve evropian (*Magna carta of judges, SSJE (2010) 3*) në parimet themelore i përcakton edhe garancitë për pavarësinë, sipas të cilave në pikën 6, shënohet se procedurat disiplinore do të mbahen para një trupi të pavarur me mundësi për paraqitjen e një mjeti në gjykatë.

Vendimet në procedurat disiplinore duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit të pavarur me mundësi që t'i shmanget mbrojtjes gjyqësore.

Procedura e tërësishme që mbahet lidhur me përgjegjësinë e gjyqtarit doemos duhet t'i respektojë standardet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe në atë drejtim t'i sigurojë garancitë procedurale në procedurë. Pamundësia e të drejtës për qasjen në gjykatë paraqet shkeljen e nenit 6 (1) nga Konventa (*Zhurek v. Poland, ECHR, 39650/18; Grzeda v. Poland, ECHR, 43572/18; Baka v. Hungary, ECHR 20261/12*).

Respektimi i garancive të nenit 6 nga Konventa Evropiane është i rëndësishëm sidomos në procedurat disiplinore kundër gjyqtarit, duke pasur parasysh çështjen e besimit të publikut në funksionimin dhe pavarësinë e gjyqësorit (*Harabin v. Slovakia, 58688/11, ECHR*).

Përderisa trupi disiplinor nuk vepron në përputhje me nenin 6 të Konventës, vendimet e procedurave disiplinore doemos t'i nënshtrohen kontrollit nga trupi gjyqësor që ka kompetencën e plotë dhe i cili i siguron garancitë e nenit 6. (*Le Compte, Van Leuven and De Meyere v. Belgium, 6878/75 u 7238/75, ECHR*).

Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për gjykim të drejtë, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nevojitet që të interpretohet në kuptim të principit të sundimit të së drejtës, sipas të cilës palët duhet të kenë mjet juridik efikas vendor si pjesë e të drejtave të tyre. (*Beles v. the Czech Republic, ECHR, 47273/99*).

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson se që të jenë mjetet juridike efektive duhet të jenë "reale dhe efektive, por jo teorike dhe iluzionare" („*Kudła v. Poland, ECHR, 30210/96*). Një nga vendimet e vetme, pa marrë parasysh atë që është arsyetuar, vet në vete nuk mjafton që të dëshmohet ekzistimi i praktikës së vendosur gjyqësore vendore që dëshmon efektivitetin e mjetit të shqyrtuar juridik. (*Horvat v. Croatia, ECHR 51585/99*).

Po ashtu, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vë në dukje nevojën dhe rëndësinë e garancive që çdo lloj vendimi për revokim, përkatësisht shkarkim të gjyqtarit do të jetë objekt i kontrollit efektiv gjyqësor (*Clarke v. United Kingdom, ECHR, 23695/02*).

Komisioni i Venecias pranë Këshillit të Evropës, vë në dukje Këshillat gjyqësorë ose Gjykatat disiplinore që t'i realizojnë procedurat disiplinore. Komisioni thekson se duhet të ketë mundësi për paraqitjen e ankesës drejtuar gjykatës kundër vendimit të trupit disiplinor (CDL-AD (2007) 028).

Komisioni tregon mungesën e mbrojtjes kur Këshilli gjyqësor nuk vepron sipas udhëzimeve të Këshillit për vendimmarrjen e ankesave pranë Gjykatës Supreme gjatë ri procedimit të tyre.

Mungon mbrojtja në kuptimin e respektimit të detyrimit të drejtpërdrejtë ligjor për veprim të detyrueshëm sipas udhëzimeve të Këshillit për vendimmarrjen e ankesave pranë Gjykatës Supreme, ndërsa subjektet, përkatësisht gjyqtarët, nuk kanë mundësi për mbrojtjen e të drejtës për ri ankesë.

Komisioni i Venecias, po ashtu, tregon vazhdimisht mungesën e mbrojtjes në rastin kur Këshilli gjyqësor nuk vepron sipas udhëzimeve të Këshillit për vendimmarrjen e ankesave gjatë ri procedimit të tyre (CDL-AD(2018)022).

V. ZBATIMI I DREJPËRDREJTË I DISPOZITAVE TË KUSHTETUTËS DHE KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Duke u nisur nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore dhe nga e drejta e konventës, rezulton se në kuptim të nenit 72 të Ligjit për Këshillin gjyqësor, gjyqtari, përkatësisht kryetari i gjykatës, në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duhet të kenë të drejtë për mbrojtje gjyqësore dhe të drejtën për mjet juridik efektiv drejtuar Këshillit për vendimmarrjen e ankesave pranë Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në formën e vendimmarrjes së ankesave në ri procedim.

Me papranueshmërinë e të drejtës së ankesave ose padisë kundër vendimit të Këshillit gjyqësor pamundësohet mbrojtja dyshkallëshe e të drejtës së ankesës që drejtpërdrejtë ndikon edhe në efikasitetin e këtij mjeti juridik dhe e kufizon të drejtën e qasjes në këtë gjykatë.

Dy shkallësh mëria në vendimmarrjen e gjykatave është e garantuar në Kushtetutën dhe paraqet një nga garancitë për sigurimin e ligjshmërisë në realizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar në përputhje me Kushtetutën janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe nuk mund të ndryshohen me ligj. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut është pjesë përbërëse e të drejtës së brendshme.

Në nenin 18 paragrafi (4) të Ligjit për gjykatat shënohet se kur gjykata konsideron se zbatimi i ligjit në rastin konkret është në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar në përputhje me Kushtetutën, do t'i zbatojë dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare, nën kushte që ato drejtpërdrejtë të mund të zbatohen. Gjatë vendimmarrjes Gjykata është e detyruar që t'i zbatojë qëndrimet e shprehura në aktgjykimet përfundimtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me nenin 18, paragrafi (4) të Ligjit për gjykatat konsideron se zbatimi i nenit 72, paragrafi (5) të Ligjit për gjykatat është në kundërshtim me dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e detyruar që të mundësojë realizimin e të drejtës së garantuar të mbrojtjes gjyqësore dhe të mjetit juridik efikas, në përputhje me Kushtetutën që nuk e kufizon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore, përkatësisht garanton se secili ka të drejtë që t'i mbrojë të drejtat e tij para gjykatave kompetente.

Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet në nenin 6 të Konventës është mundësim i subjektit të cilit i është kanosur ose kufizuar e drejta drejtpërdrejtë dhe menjëherë që të realizojë të drejtën e tij për mjetin juridik efektiv përmes qasjes në gjykatë dhe përmes sigurimit të mbrojtjes efikase gjyqësore.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**